



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:016821

Datë: 06.05.2019

Numri i dokumentit: 00299430

P.nr. 234/18

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit H. Sh. R. nga fshati P., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KP nr.06/L-074, e duke vendosur sipas aktakuzes të PTH në Prizren PP.II.nr.905-2/18 të dt. 16.05.2018, në seancën gjyqësore të mbajtur me dt.02.05.2019, në prezencë të PSH Atnor Skoro, të akuzuarit, muarrë dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari H. R., nga i ati Sh., i lindur me dt. 01.10.1953, nga fshati P., ku dhe tani jeton, i martuar baba i pesë fëmijve, penzioner, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 29.01.2018 në orë të pavërtetuar në fshatin P. Komuna e Suharekës, në shtëpin e tij merrë, përdor duke u furnizuar përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit shpërndarës pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte ku ka krijuar një lidhje direkte, duke anashkaluar njësinë elektrike, ashtu që bënë shfrytëzimin e pa autorizuar të energjis elektrike me çrast të dëmtuarës KEDS Divizioni i rrjetit - Distrikti në Prizren i shkakton dëm material në vlerë të energjis së shpenzuar.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KP-së

Gjykata në kuptim të nenit 3,38,39,46,48,69,70 si dhe nenit 314 par. 1 të KP-së , të akuzuarit, ia shqipton:

DENIMIN ME KUSHT

Të akuzuarit H. R. duke ia vërtetuar denimin me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një viti, nga dita e plotëfuqishmëris së këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës në emer te paushallit gjyqësor shumen prej 20 € dhe në emer te taksës per kompenzim te viktimave të krimit shumen prej 30 €.

E dëmtuara KEDS në Prizren, për realizimin e kërkeses pasuroro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH nga Prizreni me aktakuzën PP.II.nr.905-2/18 të dt. 16.05.2018, ka akuzuar H. Sh. R. nga fshati P., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP nr.04/L-082, aktakuzën të cilën gjate séancës gjyqësore prej fillimit gjer në mbarimin e tij e ka përfaqësuar PSH Atnor Skoro, i cili në séancë gjyqësore ka bërë rikualifikimin e veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 në veprën penale nga neni 314 par. 1 të KP nr.06/L-074, në tërsi ngel pran të dhënave si në aktakuzë te ricilësuar, që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.02.05.2019 dhe në vetë pranimin nga ana e të akuzuarit ka vërtetuar këte gjendje faktike:

Në tërsi është vërtetuar se me datën Se me datën 29.01.2018 në orë të pavërtetuar në fshatin P. Komuna e Suharekës, në shtepin e tij merrë, përdor duke u furnizuar përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit shpërndarës pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte ku ka krijuar një lidhje direkte, duke anashkaluar njësin elektrik, ashtu që bënë shfrytëzimin e pa autorizuar të energjis elektrike me çrast të dëmtuarës KEDS Divizioni i rrjetit - Distrikti në Prizren i shkakton dëm material në vlerë të energjis së shpenzuar.

Ketë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtim gjyqësor në mbrojtën e tij vullnetarisht e ka pranuar fajësin.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 259 te KPP, në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe poashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsis, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, dhe pranimi është mbështetur në faktet e qështjes që përmban aktakuza, siq janë, procesverbali me nr. 229.... të dt. 01.02.2018, raporti me numër 052... të dt. 29.01.2018, procesverbalin mbi ndrrimin e njësorit me nr. 069.... të dt. 14.11.2017 faturen rikthimi i humbjeve të dt.06.02.2018 faturen kalkulimi i RH me nr. 164... të dt. 06.02.2018, faturën me nr. 902.... të dt. 15.02.2018 si dhe fotodokumentacioni, të cilat gjinden në shkresat e lëndës si provë materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH në Prizren.

Gjykata poashtu në tërsi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsis ne shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit, është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248, nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hudhjen e aktakuzes, apo pushimin e procedurës penale nga neni 253 të KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban propozimi akuzues, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qënjes së veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KP, gjithashtu në ketë drejtim shkon edhe fakti që i akuzuari ka pranuar fajsin në tërsi, gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpallë fajtor, dhe ia shqiptoi denimin siq është cek në aktgjykim.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi denimin ka vlersuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KP, të cilat ndikojnë në lartësin e denimit.

Gjykata si rrethanë lehtësuese pati parasyshë se i akuzuari ka patur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, pranimin në tërësi të veprës së kryer, është penduar për veprën e kryer, i gjendjes jo të mirë ekonomike, kurse rrethana rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasuroro juridike u morë në kuptim të nenit 463 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 par. 1 të KPP.

Vendimi me të cilin janë të obliguar të akuzuarit që të bëjnë kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË
Departamenti i përgjithshëm
P.nr. 234/18 të dt. 02.05.2019

Sek. Juridike
F. Kabashi

G j y q t a r i
Robert Tunaj

UDHËZIME JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e paranimimit të tij ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftushme për palët dhe gjykatën.